




TË DHËNAT PËR ASETIN

Shitja e Aseteve përmes Likuidimit Nr.72 Njësia e Vendosur në Tender Nr.34 NPB Malishgan-Parcela 33-1 në ZK Binxhë

Emri i NSh.-së	NPB Malishgani, Klinë
Lloji i Shitjes	Shitje përmes Likuidimit me ofertë të mbyllur
Dita e Ofertimit	28.05.2025 nga ora 10:00h deri 12:00h në Sallën e Konferencave të "HOTEL GRAND" në Prishtinë
Çmimi Minimal	104€/ari
Depozita e Ofertës	€500
Kategoria potenciale për shfrytëzim	Bujqësore
<u>Përshkrimi i Aseteve</u>	
Vendndodhja e Aseteve	<p>Zona Kadastrale Binxhë, Komuna e Klinës.</p> <p>Të dhënat e hartës ©2024 Google</p> <p>Shikoni këtë pronë në Google Maps</p> <p>Aktmohim: Vendndodhjet e treguara nga PIN-at në Google Maps ofrohen vetëm për qëllime të orientimit dhe referencës së përgjithshme. Këto mund të mos pasqyrojnë saktësisht vendndodhjen, kufijtë ose veçori të tjera të asetëve të përshkruara. Përdoruesit këshillohen të verifikojnë në mënyrë të pavarur të gjitha vendndodhjet për çdo çështje që kërkon saktësi ose informacion me rëndësi ligjore.</p> <p>Kjo shitje përfshinë parcelën nr.33-1 me kulturë Livadh i klasës 6 në sipërfaqe prej 6ari 70m² (670m²) në ZK Binxhë, Komuna e Klinës. Parcela nr.33-1 nuk ka qasje në rrugë publike</p>
Ndërtesat dhe tokat	Nuk ka ndërtesë në këtë shitje.
Shfrytëzuesit	Aktualisht nuk ka marrëveshje për qira.
Asetet tjera	Nuk ka.
Detyrimet që do të barten	Asnjë nga detyrimet nuk do të barten tek blerësi i ri, por sidoqoftë blerësi potencial duhet të ketë parasysh se mund të jetë i aplikueshëm tatimi për bartjen e pronës.



Foto/fotot
ose informata të tjera
për asetet në shitje



Informatat rreth Njesisë lëndë e shitjes të prezantuar në Te Dhëna nuk janë të garantuara. Investitorët potencial inkurajohen të kontaktojnë Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) për të kërkuar dokumentet e tenderit. Ata të cilët dëshirojnë të paraqesin ofertë duhet të llogarisin në hulumtimet e tyre. Investitorët potencial këshillohen të bëjnë verifikimin e të dhënave vet para se të paraqesin ndonjë ofertë ose propozim për tender. Këto të Dhëna janë në dispozicion nën kushtet e përgjithshme në informatat paraprake për informacione të publikut të gjerë për kandidatët e privatizimit, e cila mund të nxirret nga faqja e internetit të AKP-së: www.pak-ks.org.




RAPORT I VIZITËS NË TERREN

NPB Malishgan, Parcela nr.33-1 z.k Binxhë, Klinë

Me datë 09.01.2025 zyrtarët e AKP-së vizituan pronën e NPB Malishgan konkretisht parcelën me nr.33-1 z.k Binxhë, Komuna e Klinës.

Parcela sipas certifikatës së pronësisë evidentohet në emër të NPB Malishgan, me sipërfaqe prej 670m² (6ari dhe 70 m²) me kulturë : bujqësore, livadh i klasës 6.



Ortofoto dhe kopja e planit për parcelën nr. 33-1 z.k Binxhë, Komuna e Klinës.

Nga vizita jonë në terren konstatuam se :

1. Për shkak të terrenit, parcela është vrojtuar nga larg;
2. Parcela nr.33-1 nuk ka qasje në rrugë publike,
3. Brenda parcelës nr.33-1 z.k Binxhë nuk evidentohet ndonjë objekt .



Raporti i vizitës në terren



Fotografia e mëposhtme prezanton gjendjen e parcelës nr. 33-1 z.k Binxhë, Klinë:



Pamje nga larg e parcelës nr. 33-1 z.k Binxhë, Klinë

D.G-Zyrtar Kadastral Rajonal, 
L.A- U.D. Udhëheqese e Ekipit të Privatizimit 

AKP- ZR PEJË/Janar 2025

**Informatat dhe
Dokumentet e Ofertimit**

Divizioni i Marketingut dhe Tenderit Publik
Tel: +383 (0) 38 500 400 lok.1090, 2059
www.pak-ks.org
Agjencia Kosovare e Privatizimit
Rr. Dritan Hoxha, nr.55
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës